



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETARI

Nr. 0622 Prot

Shkodër, më 25.01.2024

Lënda: Dërgohet për shqyrtim projekt-vendimi dhe relacioni

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar Këshilltarë,

Bashkëlidhur Ju dërgojmë për shqyrtim projekt-vendimin dhe relacionin:

“Për miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionit të qirasë për ato individë/familje që nuk përballojnë qiranë e tregut të lirë për vitin 2024”.

Duke ju uruar punë të mbarë!

Me respekt,

KRYETAR

Benet Beci

ME VENDIM DELEGIMI

ZV/KRYETAR

Onid Bejleri



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

KRYETARI

Nr. _____ Prot.

Shkodër, më _____ 2024

PROJEKT – VENDIM

Nr. _____, datë _____ 2024

“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE DHE VLERËS SË SUBVENCIONIT TË QIRASË PËR ATO INDIVIDË/FAMILJE QË NUK PËRBALLOJNË QIRANË E TREGUT TË LIRË PËR VITIN 2024”.

Këshilli Bashkiak Shkodër në mbledhjen e tij të datës _____ 2024, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, në mbështetje të nenit 24, pika 2, të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar; të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e Qeverisjes Vendore”, i ; të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar; të nenit 39, pika 3, të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar; VKM-së nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve e të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”; VKM-së nr. 362, datë 20.05.2019 “Për kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij”; VKM-së nr. 459, datë 3.7.2019 “Rregullat për administrimin e kërkesave të njëjësive të vetëqeverisjes vendore për fonde nga buxheti i shtetit për subvencionimin e qirasë ose uzufuktit, mënyrën e financimit të subvencionimit, monitorimin dhe bashkëpunimin ndërmjet njëjësive të vetëqeverisjes vendore dhe ministrisë përgjegjëse për strehimin”; Udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019 “Për procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e strehimit; VKB-së nr. 55, datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024 dhe programin buxhetor afatmesëm përfundimtar 2024-2026 të bashkisë Shkodër”, VKB-së nr.25, datë 13.9.2023 “Për miratimin e sistemeve të pikëzimit për programet e strehimit social”; shkresës së Ministrisë së Financave “Mbi thirrjen për bonusin e qirasë për vitin 2024”, datë 12.01.2024 ; “Procesverbalit të Komisionit të Strehimit pranë Bashkisë Shkodër”, me nr. 20286/1 prot, datë 28.12.2023”, “Procesverbalit të Komisionit të Strehimit pranë Bashkisë Shkodër”, me nr.1180/1

prot, datë 22.01.2024”, si dhe Relacionit të administratës së Bashkisë Shkodër, me nr. _____ prot,
datë _____

VENDOSI:


1. Të miratojë listën e përfituesve dhe vlerën e subvencionit të qirasë për ato individë/familje që nuk përballojnë qiranë në tregun e lirë për vitin 2024, sipas tabelës nr. 1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij vendimi.
2. Kohëzgjatja e pagesës së qirasë për individët/familjet e përcaktuara në pikën 1, do të jetë për një periudhë I (një-vjeçare).
3. Efektet financiare që rrjedhin nga pika “1”, në shumën totale **11,750,852** lekë do të përballohen nga fondi i buxhetit të shtetit (grant i kushtëzuar) me bashkëfinancim të Bashkisë Shkodër që do të jetë jo më pak se 30% të vlerës totale, i parashikuar në programin 10661 Strehimi social në fishprojektin P10661.Q1.O1.A2, Zbatimi i instrumentit financiar :“ Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë „
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

KRYETAR
Benet Beci


ME VENDIM DELEGIMI
ZV/KRYETAR
Onid Bejleri




Drejtoria Juridike



Drejtoria e Shërbimeve Sociale,
Strehimit dhe Shëndetit Publik



Drejtoria e Financës





Llogaritja e masës së subvencionimit të qirarë

Nr	Emër	Atësi	Mbiemër	Kategoria sipas nenit 16, të ligjit nr. 22/2018, i ndryshuar	Përbërja Familjare	Qiraja mesatare	Struktura/ Superfaqja m ²	Të ardhurat familjare mujore	Kategori a (sipas pikës 45, të nenit 2, të ligjit nr. 22/2018, i ndryshuar	Aftësia përballu ese	Qiraja e përballu sime	Subvencion i në muaj	Subvenci oni në muaj që mbulohet nga bashkia në Lekë	Shuma që kërkohet nga buxheti në Lekë	Subvencion i që mbulohet nga bashkia në vit në Lekë	Subvencion i në vit në Lekë	Shuma që kërkohet nga buxheti në vit në Lekë
1	Ardita	Xhemal	Hasanaj	Familje njëprindërore	4	25,000	60	-	€	0%	-	25,000	7,500	17,500	300,000	90,000	210,000
2	Edona	Minyr	Abdija	Familje njëprindërore	3	20,000	105.5	-	€	0%	-	20,000	6,000	14,000	240,000	72,000	168,000
3	Viserjona	Musa	Qokthi	Familje njëprindërore	3	16,000	121	-	€	0%	-	16,000	4,800	11,200	192,000	57,600	134,400
4	Marjana	Gjon	Gjonpjetri	Familje njëprindërore	4	18,700	52	-	€	0%	-	18,700	5,610	13,090	224,400	67,320	157,080
5	Sucle	Ferid	Qerrelli	Familje njëprindërore	3	17,700	80	-	€	0%	-	17,700	5,310	12,390	212,400	63,720	148,680
6	Malvina	Gjon	Ejlli	Familje njëprindërore	2	11,000	57	-	€	0%	-	11,000	3,300	7,700	132,000	39,600	92,400
7	Pranverë	Lazer	Pjetri	Familje njëprindërore	2	12,000	105.5	-	€	0%	-	12,000	3,600	8,400	144,000	43,200	100,800
8	Donik	Rrok	Rrotani	Familje njëprindërore	2	16,000	72	-	€	0%	-	16,000	4,800	11,200	192,000	57,600	134,400
9	Elmira	Xhabir	Hasaj	Familje njëprindërore	4	12,000	56	-	€	0%	-	12,000	3,600	8,400	144,000	43,200	100,800
10	Vera	Pashko	Bardhi	Familje njëprindërore	3	10,000	50	-	€	0%	-	10,000	3,000	7,000	120,000	36,000	84,000
11	Ervin	Meto	Metushi	Te Rinj. PAK	1	14,000	70	-	€	0%	-	14,000	4,200	9,800	168,000	50,400	117,600
12	Tone	Nikoll	Lami	Familje njëprindërore	4	20,000	80	35,520	€	15%	3,000	17,000	5,100	11,900	204,000	61,200	142,800
13	Akela	Përparrim	Lama	Familje njëprindërore	3	20,000	52	35,520	€	15%	3,000	17,000	5,100	11,900	204,000	61,200	142,800
14	Jurgena	Gezim	Pecaj	Familje njëprindërore	2	15,000	44	35,520	€	15%	2,250	12,750	3,825	8,925	153,000	45,900	107,100
15	Fajtonë	Cuf	Bashkimi	Familje njëprindërore	4	20,000	51	34,120	€	15%	3,000	17,000	5,100	11,900	204,000	61,200	142,800
16	Pashke	Martin	Lami	Familje me shume se 4 femije	7	22,000	78	-	€	0%	-	22,000	6,600	15,400	264,000	79,200	184,800
17	Violetë	Ndoc	Lulashi	Familje me shume se 4 femije	8	285,000	163,7	-	€	0%	-	285,000	85,500	199,500	3,420,000	1,026,000	2,394,000
18	Mire	Pashko	Rrethaj	Familje e Re	5	12,000	145.2	-	€	0%	-	12,000	3,600	8,400	144,000	43,200	100,800
19	Pashke	Zef	Susaj	Familje e Re	5	25,000	78	-	€	0%	-	25,000	7,500	17,500	300,000	90,000	210,000
20	Nobel	Valentin	Mirashi	PAK	1	15,000	54	0	€	0%	-	15,000	4,500	10,500	180,000	54,000	126,000
21	Hyrrije	Ymer	Kraja	PAK	1	11,000	24	-	€	0%	-	11,000	3,300	7,700	132,000	39,600	92,400
22	Vjollca	Salih	Harifi	PAK	3	20,000	56	-	€	0%	-	20,000	6,000	14,000	240,000	72,000	168,000
23	Shpresa	Sulejman	Çanga	E moshuar, Iirim banese ish-pronarëve	1	15,000	78	23,221	€	15%	2,250	12,750	3,825	8,925	153,000	45,900	107,100
24	Drandë	Dede	Marku	PAK	3	16,000	75	0	€	0%	-	16,000	4,800	11,200	192,000	57,600	134,400
25	Farije	Man	Muço	PAK	4	20,000	57	-	€	0%	-	20,000	6,000	14,000	240,000	72,000	168,000
26	Xhuljeta	Gjon	Vataj	Familje njëprindërore	2	16,000	56	68,903	€	25%	4,000	12,000	3,600	8,400	144,000	43,200	100,800
27	Tereze	Mark	Beroshi	PAK	4	20,000	52	-	€	0%	-	20,000	6,000	14,000	240,000	72,000	168,000
28	Dritana	Rifat	Ballistani	PAK	1	15,000	61	-	€	0%	-	15,000	4,500	10,500	180,000	54,000	126,000
29	Gjina	Simon	Ndrou	PAK	1	16,000	50.44	-	€	0%	-	16,000	4,800	11,200	192,000	57,600	134,400
30	Trendelina	Avdulla	Zrisko	PAK	2	12,000	52	-	€	0%	-	12,000	3,600	8,400	144,000	43,200	100,800
31	Kimete	Halil	Koplikaj	Të moshuar	1	10,000	56	15,230	€	15%	1,500	8,500	2,550	5,950	102,000	30,600	71,400
32	Pranvera	Zeqir	Shahja	Të moshuar	1	12,500	82.8	6,316	€	15%	1,875	10,625	3,188	7,438	127,500	38,250	89,250
33	Nedrete	Enver	Matë	Të moshuar	1	16,000	30	11,614	€	15%	2,400	13,600	4,080	9,520	163,200	48,960	114,240


35	Antuela	Gjovalin	Gjekaj	4	16,000	50	35,520	€	0%	-	16,000	4,800	11,200	192,000	57,600	134,400
36	Kujtime	Met	Meti	4	12,000	88,60	-	€	0%	-	12,000	3,600	8,400	144,000	43,200	100,800
37	Pllumb	Nikë	Staka	1	10,000	57	-	€	0%	-	10,000	3,000	7,000	120,000	36,000	84,000
38	Violeta	Gjergj	Garupi	4	20,000	114,40	-	€	0%	-	20,000	6,000	14,000	240,000	72,000	168,000
39	Violeta	Zef	Pepniku	2	15,000	52,63	-	€	0%	-	15,000	4,500	10,500	180,000	54,000	126,000
40	Sadedin	Adem	Hadri	3	16,000	60	-	€	0%	-	16,000	4,800	11,200	192,000	57,600	134,400
41	Maliq	Elez	Pepa	1	12,000	60	-	€	0%	-	12,000	3,600	8,400	144,000	43,200	100,800
42	Sadiq	Mehmet	Ceni	1	16,000	64,8	-	€	0%	-	16,000	4,800	11,200	192,000	57,600	134,400
43	Liljana	Ndoc	Lutashi	2	10,962	63	28,539	€	15%	1,644	9,318	2,795	6,522	111,812	33,544	78,269
44	Zef	Deđe	Bulku	4	18,700	70	35,520	€	15%	2,805	15,895	4,769	11,127	190,740	57,222	133,518
45	Genjan	Urhan	Selhanecj	2	15,000	47	32,897	€	15%	2,250	12,750	3,825	8,925	153,000	45,900	107,100
46	Vitor	Zef	Lejtihija	2	16,000	56	35,520	€	15%	2,400	13,600	4,080	9,520	163,200	48,960	114,240
47	Leke	Mark	Shkambi	1	16,000	70	35,520	€	15%	2,400	13,600	4,080	9,520	163,200	48,960	114,240
				4	17,000	95	34,020	€	15%	2,550	14,450	4,335	10,115	173,400	52,020	121,380
						Totali	979,238			293,771	685,466	11,750,852	3,525,256	8,225,597		

Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Shprehim, Shëndetit Publik

Gjuri Thaçiu

KRYETAR

Benet Beci





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA SHKODËR

Nr. _____ Prot

Shkodër, më _____.____.2024

RELACION

“PËR MIRATIMIN E LISTËS SË PËRFITUESVE DHE VLERËS SË SUBVENCIONIT TË QIRASË PËR ATO INDIVIDË/FAMILJE QË NUK PËRBALLOJNË QIRANË NË TREGUN E LIRË PËR VITIN 2024.”

KËSHILLIT BASHKIAK SHKODËR

Të nderuar Këshilltarë,

Në zbatim të ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social”, i ndryshuar, Bashkia Shkodër po zbaton disa nga programet sociale të strehimit, që kanë si qëllim krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm për familjet që kanë nevojë për strehim.

Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë si një instrument financiar i programit social të strehimit “Banesa sociale me qira”, mbështet individë/familje që me të ardhurat e tyre nuk përballojnë pagesën e qirasë reale në tregun e lirë. Subvencionimi i qirasë realizohet nga Bashkia kur nuk disponon banesa sociale me qira si dhe kur nuk zotërojnë fonde për investime të reja ose blerje banesash në treg.

Për këtë instrument financiar, në zbatim të programit të banesave sociale me qira, aplikimet kanë qenë të hapura deri në muajin nëntor 2023.

Të gjithë aplikuesit e kualifikuar në fazën e parë janë njoftuar për plotësimin dhe dorëzimin e dokumentacionit të nevojshëm dhe janë mbështetur nga struktura përgjegjëse për strehimin në Bashki.

Në total kanë qënë 84 aplikues për këtë instrument financiar. Për fazën e dytë të procedurës aplikuesit janë njoftuar me shkresë për plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm. Nga 84 aplikues , 9 nuk i janë përgjigjur fazës së dytë të aplikimit(nuk kanë sjellë dokumentacion), 2

aplikues janë tërhequr, 19 kanë patur mangësi në dokumentacion dhe 54 aplikues kanë patur dokumentacionin e rregullt për t'i kaluar për shqyrtim dhe vlerësim Komisionit të Strehimit.

Lista e propozuar për miratim përmbante 54 aplikues të renditur sipas sistemit të pikëzimit, nga të cilët 34 janë përfitues të këtij programi/instrumenti financiar për vitin 2023, dhe pas përditësimit të dokumentacionit do të risubvencionohen për vitin 2024.

Në mbledhjen e Komisionit të Strehimit të datës 28.12.2023, është vlerësuar të kalojë për miratim lista e përfituesve të instrumentit financiar të subvencionit të qirasë në treg të lirë për vitin 2024, sipas procesverbalit të mbledhjes së Komisionit, me nr. 20286/1 prot, datë 28.12.2023.

Në zbatim të nenit 39, të ligjit nr. 22/2018 "Për Strehimin Social", i ndryshuar, përfituesit kanë detyrim ligjor të dorëzojnë kontratën e qirasë brenda afateve kohore ligjore pas miratimit të listës së përfituesve nga Komisioni i Strehimit për të përcaktuar dhe vlerën e subvencionimit të qirasë.

Nga 54 përfitues të listës së miratuar, 7 prej tyre janë tërhequr duke vetdeklaruar për pamundësinë e sigurimit të një kontrate duke mbetur në listën përfundimtare 47 përfitues.

Llogaritja e vlerës së subvencionimit të qirasë bazohet në VKM nr. 362, datë 20.05.2019 "Për kriteret e dhënies së subvencionimit të qirasë për kategoritë që gëzojnë përparësi në subvencionimin e qirasë në tregun e lirë, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe mënyrën e llogaritjes së tij", shtojca "A", dhe realizohet në varësi të të ardhurave të familjes sipas përcaktimeve ligjore dhe vlerës mesatare të qirasë në treg të lirë të miratuar me VKB.

Vlerat konkrete të subvencionimit të qirasë për çdo përfitues, përcaktohen sipas kontratave të qirasë, të cilat nuk kalojnë vlerat e përcaktuara sipas shtojcës "A" të VKM-së 362, datë 20.05.2019.

Në mbledhjen e datës 22.01.2024 Komisioni i Strehimit vendos të paraqesë për miratim Këshillit të Njësisë së Vetëqeverisjes Vendore, listën e përfituesve dhe vlerën e subvencionit të qirasë për instrumentin financiar "Subvencionimi i qirasë në tregun e lirë" për vitin 2024.

Lista e përfituesve dhe vlerat e subvencionit të qirasë janë të pasqyruara në tabelën bashkëlidhur projekt-vendimit.

Referuar pikës 7, të Udhëzimit të Ministrit nr. 31, datë 18.11.2019 "Për procedurat standarde të aplikimit dhe kriteret për përfitimin e fondeve nga buxheti i shtetit për programet e Strehimit", përditësuar, bashkëfinancimi përcaktohet në varësi të të ardhurave për frymë të NJVV-ve dhe duke iu referuar publikimeve periodike në faqen e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Bashkia Shkodër rezulton me të ardhura vjetore për frymë në vlerën 5,388 mijë lekë që sipas Tabelës nr.3 të Udhëzimit nr. 31, datë 18.11.2019: "Të ardhurat për frymë të NJVV-ve (mijë

lekë) në vlerat 4,001-6,000 lekë financohen deri në 70% nga buxheti i shtetit.”


Sa më sipër, Bashkia Shkodër duhet të bashkëfinancojë për këtë program social të strehimit jo më pak se 30% të vlerës totale të subvencionimit të qirasë në treg të lirë.

Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij programi social të strehimit janë në shumën totale 11,750,852 lekë dhe do të përballohen nga fondi i buxhetit të shtetit (grant i kushtëzuar), me bashkëfinancim të Bashkisë Shkodër, që do të jetë jo më pak se 30% të vlerës totale, sipas thirrjes së Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, me shkresën nr. 747 prot, datë 12.01.2024.

Në këto kushte, për realizimin e këtij programi social të strehimit duhet të miratohet në Këshill Bashkiak projekt-vendimi i propozuar: “Për miratimin e listës së përfituesve dhe vlerës së subvencionit të qirasë për ato individë/familje që nuk përballojnë qiranë e tregut të lirë për vitin 2024”.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Strehimit, Shëndetit Publik

Glux Kacerrri 

KRYETAR

Benet Beci

ME VENDIM DËLËGIM
ZV/KRYETAR
Orida Bejleri

